Cultural heritage
management plans
in the Western Balkans

Plani i Menaxhimit për
HAMAMIN E GAZI MEHMET PASHËS,
PRIZREN

RCCTFCS
Regional Cooperation Council
Task Force on Culture and Society

RegionalCooperationCouncil

LJUBLJANA PROCESS
REHABILITATING OUR COMMON HERITAGE

IMPRESSUM

Projekti "Përgatitja e Planeve të Menaxhimit për lokalitetet dhe trajnimet respektive" u financua nga Kontratë Granti i BE-RCC "Mbështetja e Rehabilitimit të Trashëgimisë Kulturore në Ballkanin Perëndimor" dhe u zbatua nga një grupim partnerësh rajonalë – Trashëgimia Kulturore pa Kufij si udhëheqës i grupimit, Europa Nostra Serbi, EXPEDITIO – Qëndra për Zhvillim të Qëndrueshëm Hapësinor, Mal i Zi dhe Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri. Projekti u koordinua nga Task Forca për Kulturë dhe Shoqëri (RCCTFCS), në mbështetje të zbatimit të suksesshëm të Procesit të Lubjanës II: Rehabilitimi i Trashëgimisë së përbashkët.

Autorët
Mirian Bllaci, Nora Arapi, Bekim Çeko

Ekspertët lokalë të angazhuar në lokalitetet në rajon:
Lorenc Bejko, Borče Dimitrovski, Maja Djordjević, Biljana Gligorić, Aleksandra Kapetanović, Višnja Kisić, Ols Lafe, Jasmina Mazgalieva, Orjana Mujkić Lenasi, Amra Šarančić Logo, Danijela Vićentijević

Ekspertet kyçe:
(1) Katarina Živanović, (2) Aida Vežić, (3) Lejla Hadžić

DEKLARATA E VIZIONIT

Hamami, për çdo disponim, për çdo moshë, për çdo stinë, për çdo vend.

PËRMBAJTJA

1. PRAPAVIJA DHE QËLLIMI I PLANIT 5
2. PROCESI – SI ËSHTË HARTUAR PLANI DHE KUSH ËSHTË PËRFSHIRË 6
   2.1 Identifikimi I Palëve Të Interesit 6
   2.2 Përfshirja e palëve të interesit në proces 7
3. PËRSHKRIMI I LOKALITETIT 8
   3.1 Përshkrimi historik 8
   3.2 Përshkrimi 8
   3.3 Përcaktimi i kufijve dhe hapësirave rrethuese 10
4. VLERAT DHE RËNDËSIA 12
   4.1 Vlerat 12
   4.2 Deklarata e rëndësisë 14
5. VLERËSIMI I GJENDJES / GJËRAT ELEMENTARE 15
   5.1 Korniza institucionale dhe ligjore 15
   5.2 Menaxhimi i lokalitetit 16
   5.3 Planifikimi dhe strategjia që ndikon në lokalitet 16
   5.4 Shfrytëzimi i lokalitetit në të kaluarën dhe sot 18
   5.5 Gjendja & Konservimi i lokalitetit 18
   5.6 Siguria 19
   5.7 Prezantimi dhe interpretimi i lokalitetit 19
   5.8 Edukimi 21
   5.9 Hulumtimi 21
   5.10 Vlerësimi i Menaxhimit dhe qasja e vizitorëve 22
   5.11 Vlerësimi i përfshirjes së komunitetit dhe mardhëniet 23
   5.12 Vlerësimi i komunikimit dhe marketingut 24
   5.13 Potenciali dhe përfitime ekonomike dhe sociale 24
   5.14 Vlerësimi i faktorëve, efekteve dhe rreziqeve që ndikojnë në trashëgimi 25
6. ANALIZA SWOT 26
7. VIZIONI DHE PARIMET 29
   7.1 Deklarata e vizionit 29

7.2 Parimet udhëzuese....29
8. OBJEKTIVAT PËR PËRDORIMIN, MBROJTJEN DHE KOMUNIKIMIN RRETH LOKALITETIT..30
8.1 Qëllimet krzesore lidhur me Planin e Menaxhimit të Hamamit të Gazi Mehmed Pashës....30
9. FUSHAT SPECIFIKE PËR NDËRHYRJE DHE VEPRIM....32
9.1 Çështjet organizative të menaxhimit dhe të vendimarrjes....32
9.2 Mbrojtja e lokalitetit....34
10. IMPLEMENTIMI DHE MONITORIMI....38
10.1 Dokumentacioni për Implementim dhe Monitorim....38
10.2 Sistemi i aprovimit të planeve....38
10.3 Monitorimi & Rishikimi....39
10.4 Burimet....39
11. PLANI I VEPRIMIT (PËRFSHIRË KOHËN, PRIORITETET, BURIMET DHE INDIKATORËT)..40
12. SHTOJCAT....50

PRAPAVIJA DHE QËLLIMI I PLANIT

Hartimi i planeve të menaxhimit për lokalitete së bashku me trajnimin relevant, në kuadër të kontratës për grante të BE-së "Mbështetja e Rehabilitimit të Trashëgimisë Kulturore në Ballkanin Perëndimor"

Plani i Menaxhimit për Hamamin e Gazi Mehmed Pashës në Prizren, u hartua nga Qershori deri në Tetor 2014. Dokumenti final është një prej shtatë planeve të menaxhimit për vendet e trashëgimisë në shtatë vende të Europës Juglindore, në mbështetje të zbatimit të veprimtarive në kuadër të "Procesit të Lubjanës II: Rehabilitimi i Trashëgimisë së përbashkët", i koordinuar nga Task Forca për Kulturë dhe Shoqëri të Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit, i mbështetur nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës.

Për hartimin e shtatë planeve të menaxhimit u formua një grupim rajonal që përfshin organizmat në vijim - Trashëgimia Kulturore pa Kufij si udhëheqës i grupimit, Europa Nostra Serbi, EXPEDITIO – Qëndra për Zhvillim të Qëndrueshëm Hapësinor, Mal i Zi dhe Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri. Zhvillimi i planeve të menaxhimit rezultoi nga nevoja për të planifikuar funksionimin afat-gjatë të vendeve të përzgjedhura të trashëgimisë – administrimin e tyre, qëndrueshmërinë si dhe programimin, të nevojshme për arritjen e ndryshimeve pozitive për zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Një metodologji e përbashkët për zhvillimin e planeve të menaxhimit për shtatë lokaliteteve është hartuar, duke marrë parasysh ndryshimet në natyrë, karakteristikë dhe kushtet e lokaliteteve individuale si dhe të dallimeve në kontekstin lokal, kombëtar, shoqëror-politik, ligjor, kulturor, dhe ekonomik.

Përpos metodologjisë së përbashkët e cila do të përcjellet si bazë për përgatitjen e planeve të menaxhimit për shtatë lokalitete, aktivitete specifike do të organizohen në secilin shtet në përputhje me specifikat, nevojat dhe kërkesat e secilit lokalitet, si dhe ligjet dhe rregulloret kombëtare relevante.

PROCESI – SI ËSHTË HARTUAR PLANI DHE KUSH ËSHTË PËRFSHIRË

2.1 IDENTIFIKIMI I PALËVE TË INTERESIT

Gjatë fazës së parë të hartimit të planit të menaxhimit për Hamamin e Gazi Mehmed Pashës, fillimisht janë identifikuar dy grupe të interesit. Pronari legjitim i lokalitetit dhe institucionet përgjegjëse për ruajtjen dhe menaxhimin e Hamamit janë identifikuar si palë kyçe të interesit të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të lidhur më shfrytëzimin e monumentit në të kaluarën, tashmen dhe në të ardhmen.

Palët kyçe të interesit për Hamamin e Prizrenit:

Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren – pronar legjitim i monumentit;

Komuna e Prizrenit – institucion lokal përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e qytetit në përgjithësi dhe të qendrës historike të Prizrenit, pjesë e së cilës është Hamami i Gazi Mehmed Pashës;

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – institucion qendror përgjegjës për ruajtjen dhe menaxhimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë* ;

Qendra Regjionale për Trashëgimi Kulturore në Prizren – institucion vartës i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përgjegjëse për ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Komunën dhe regjionin e Prizrenit;

Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Prizrenit – e themeluar në bazë të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Ligj Nr. 04/L-066) dhe është trup përgjegjës për mbikëqyrjen dhe këshillimin rreth aktiviteteve të zhvilluara brenda kufijve të zonës historike të Prizrenit;

Rrjeti i Organizatave të Kulturës – rrjet joformal i organizatave të kulturës aktive në Komunën e Prizrenit. Ky rrjet përbëhet nga 23 organizata jo-qeveritare të cilët kanë për qëllim pasurimin e sektorit kulturor, rritjen e kualitetit të aktiviteteve ekzistuese kulturore dhe përmirësimin e politikave kulturore në nivel lokal;

Krahas palëve kyçe të interesit, Hamami i Gazi Mehmed Pashës shfrytëzohet për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, artistike, sociale dhje humanitare. Ky monument paraqet obkejtin kyç publik të shfrytëzuar nga komunitete të ndryshme që jetojnë dhe veprojnë në Prizren.

Rrjedhimisht, palët tjera të interesit të cilët janë të përfshirë në forma të ndryshme në funksionimin e Hamamit, gjithashtu janë identifikuar.

Palët e tjera të interesit të kyçura në proces:

OJQ EC MA Ndryshe – qëllimet kryesore të kësaj organizate janë promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore.

*Ky identifikim është pa paragjykime ndaj pozicioneve rreth statusit dhe është në pajtim me rezolutën 1244 të KSKB dhe Opinionin e GJND'së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Dokufest– është një OJQ e cila organizon festivalin vjetor ndërkombëtar të filmave dokumenatrë dhe atyre të shkurtër "Dokufest"/ Aktivitet të shumta të Dokufestit janë organizuar në hapësirën e Hamamit, sikurse: ekspozita Dokuphoto, debate, punëtori dhe tryeza të rrumbullkta.

Sculpfest- Festivali ndërkombëtar i skulpturës në Prizren, i cili ndahet në tri departamente: Sculp'ice; Sculp'edu dhe Sculp'biennale. Aktivitet e Scul'edu që përfshinë puëntori dhe debate të shumta organizohen në hapësirat e Hamamit.

Akea – Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsimin i cili organizon aktivitete të shumta kulturore dhe humanitare në Komunën e Prizrenit. Njëri prej aktiviteteve të Akea, Panairi Kulturor zhvillohetnë oborrin e Hamamit.

Xhennet Comics – OJQ e cila promovon artin e karikaturës dhe të librave komik, të cilët kanë organizuar ekspozita të shumta në hapësirën e Hamamit.

Përpos OJQ-ve të lartpërmendura që merren me zhvillimin e aktiviteteve kulturore, ekzistojnë edhe palët tjera të interesit të cilët janë të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të planit të menaxhimit për Hamamin e Gazi Mehmed Pashës:

Asociacioni shqiptar numizmatik; Asociacioni gratë për gratë me aftësi të kufizuara; Asociacioni i distrofisë; Orkestra e Prizrenit; Kuarteti Pentagram; asociacioni muzikor Dogru Yol; asociacioni i Filigranit; CHwB zyra në Kosovë*; UN Habitat zyra në Kosovë* etj.

2.2 PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT NË PROCES

Procesi i hartimit të planit të menaxhimit për Hamamin e Gazi Mehmed Pashës ishte jjë proces interaktiv dhe zhvillimi i tij është arritur nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të palëve të identifikuara të interesit, në bashkëpunim të ngushtë më Udhëheqësin Kombëtar të Projektit, Ekipin e Ekspertëve Lokal, dhe Ekipin e Ekspertëve Kyç.

Tri punëtori me palët relevante të interesit janë mbajt në Prizren në datat:

- 5 gusht 2014
- 16 shtator 2014 (punëtoria e mbajtur në Hamam)
- 9 tetor 2014

Punëtoritë u karakterizuan më angazhim konstant të palëve kyçe të interesit si dhe me një sërë diskutimesh të hapura dhe konstruktive në mes të pjesëmarrësve.

Përfshirja e palëve të ndryshme të interesit në procesin e hartimit të dokumenteve teknike dhe të planit të menaxhimit është paraqitur në Aneksin 3.

PËRSHKRIMI I LOKALITETIT

3.1 PËRSHKRIMI HISTORIK

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është një monument i periudhës së hershme Osmane ku janë të kombinuar traditat orientale me ato lokale. Është ndërtuar në qendër të qytetit në vitin 1563/4 nga Gazi Mehmed Pasha, në kohën e njëjtë kur ka qenë duke u ndërtuar edhe Xhamia në afërsi të Hamamit. Hamami ka dy kupola të mëdha dhe nëntë tjera të vogla, dhe është e ndarë në pjesën për meshkuj dhe për femra. Si njëri prej hamameve më specifike në Evropën Jug-lindore, Hamami posedon vlera të larta arkitekturale, historike, kulturore dhe shoqërore. E integruar në jetën e qytetarëve për shekuj me radhë, Hamami është shndërruar në simbolin shpirtëror dhe të trashëgimisë kulturore të Prizrenit dhe regjionit.[2]

Ndërtesa ka funksionuar si hamam deri në vitin 1944. më pas ka shërbyer si punëtori për prodhim të djathit, si depo dhe më vonë si hapësirë për organizim të aktiviteteve kulturore. Në vitin 1954 është vënë nën mbrojtje të shtetit dhe është riparuar dhe mirëmbajtur deri në vitin 1981. Pas këtij viti Hamami është lënë pas dore në mëshirë të kohës. Pas intervenimeve të NATOs në Kosovë* në vitin 1999, disa veprime të kufizuara janë ndërmarr për ruajtjen e monumentit.[3]

3.2 PËRSHKRIMI

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është hamam çift, që nënkupton se posedon hapësira të ndara për shfrytëzim nga meshkujt dhe femrat. Është ndërtuar nga gur lumor dhe tulla drejtkëndëshe të lidhur me llaç horasan. Karakterizohet me strukturën e 20 kupolave; dy më të mëdha janë mbuluar me qeramidhe, kurse kupolat tjera më të vogla kanë qenë të mbuluar me pllaka guri. Në vitin 1979 mbulesa me pllakat e gurit është zëvendësuar me pllaka plumbi. Enterieri përbëhet nga nefe të shumta të vendosura njëra pas tjetrës.

Bërthama arkitektonike e Hamamit përbëhet nga:[4]

Zona e ftohtë – zhveshtorja:	Hapësirë e klimatizuar me një fontanë në mes;
	Kthinat shtesë;
Zona ndërmjetëse:	Garderoba - *apodyteria*;
Zona e ngrohtë – *tepidarium*:	Kthinat për rruarje;
	Kthinat për depilim;
	Kthinat për masazhë;

[2] Preliminary Technical Assessment of the Architectural and Archaeological Heritage in South East Europe - The Hammam of Gazi Mehmed Pasha Prizren, Kosovo*, 2013.
[3] Ibid.
4 Actual condition and Restoration project drafted by the professional staff of the Institute for Protecting Monuments in Prizren: Prof. Dr. Zeynep Ahunbay, Ing. Arch. Jusuf Xhibo, Ing. Arch. Fikret Tikvesh, B.Arch. Besart Dajçi, Ing. Arch. Nehari Toçilla, Ing. Arch. Kadër Vogël, in 2011, Prizren, Kosovo*.

	Tualetet;
Zona e nxehtë –*caldarium*:	Hapësira e larjes –sauna;
Zona teknike - *qylhani*:	Depoja e ujit;
	Oxhaku



Destinimi i sipërfaqeve në përdhesën e Hamamit [5]

Ngrohja është realizuar nëpërmjet sistemit të hipokausteve. Uji dhe gazrat janë liruar nga depoja e ujit të ngrohtë, nëpërmjet kanaleve të vendosura nën dysheme. Ndriçimi është realizuar nga 6 dritare dhe mbi 300 hapje në kupola. Sipërfaqja e Hamamit mbulon 733m^2.

[5] Jusuf Xhibo, Fikret Tikves, Besart D., Nehari T, Kadër V., *GMP Existing State 4a Ground Floor*, IPM Pz, 2011, Prizren, Kosovo*.

Mbrojtja ligjore

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është shpallur monument nën mbrojtje të shtetit që nga viti 1954. Ndërtesa gjendet në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme për vitet 2011-2012-2013.

Ky monument mbrohet sipas ligjeve: Ligji i Trashëgimisë Kulturore (Ligji Nr. 02/L-88)[6], Ligji mbi Zonat e Veçanta të Mbrojtura[7] (Ligji Nr. 03/L-039) dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit[8] (Ligji Nr. 04/L-066).

Në nivelin lokal, Komuna e Prizrenit në dhjetor të vitit 2008 ka adoptuar Planin e Konservimit dhe të Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, i cili shërben si plan rregullues për zonën historike të Prizrenit. Hamami i Gazi Mehmet Pashës gjendet në nën-zonën V: Zona e Aksit Komercial.

3.3 PËRCAKTIMI I KUFIJVE DHE HAPËSIRAVE RRETHUESE

Në bazë të :Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, Neni 6.4 "*Monumentet arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet në planin e Institucionit kompetent dhe në planet hapësinore relevante në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.*"

Krahas përcaktimit gjeneral në ligj, nuk janë përcaktuar kufij specifik për Hamamin e Gazi Mehmed Pashës.

Në aspektin urban, Hamami është i vendosur në zonën historike të Prizrenit, në qendër të qytetit. Është pjesë e kompleksit të Gazi Mehmed Pashës i cili përmban një xhami, tyrben dhe medresen (shkollën). Pranë Hamamit gjendet edhe monumente tjera me rëndësi, sikurse Xhamia e Emin Pashës, minarja e xhamisë Arasta, xhamia e Saraçhanes, teqaj Halveti dhe disa shtëpi tradicionale që datojnë nga shek. 19.

[6]Cultural Heritage Laë, 2006, http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2006_02-L88_en.pdf
[7]Laë on Special Protective Zones, 2008, http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L039_en.pdf
[8]Laë on Historic Centre of Prizren, 2012, http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20Historic%20Centre%20of%20Prizren.pdf



Cultural heritage monuments around the Hammam[9]

[9] Jusuf Xhibo, Fikret Tikves, Besart D., Nehari T, Kadër V., *GMP Restoration – Interventions - Situation* IPM Pz, 2011, Prizren.

VLERAT DHE RËNDËSIA

4.1 VLERAT

Hamami i Prizrenit përmban vlera të rëndësishme arkitekturale, historike dhe kulturore për qytetin dhe regjionin. Si një monument nga periudha e hershme Osmane, ai është njëri prej hamameve më të rëndësishme në Evropën Jug-lindore. Hamami është i veçantë në aspektin arkitektural dhe kulturor, duke ngërthyer traditat arkitekturale, kulturën orientale dhe lokacionin ku gjendet. Ndarja fizike e Hamamit në pjesën për meshkuj dhe femra është një veçori që e dallon këtë ndërtesë nga hamamet tjera në regjion.

I ndërtuar në qendër të qytetit, Hamami për shekuj me radhë ka qenë pjesë e pandashme e jetës së qytetarëve të Prizrenit dhe është shndërruar në simbol shpirtëror dhe kulturore për qytetin dhe regjionin.

Vlerat	***Shpjegimet***
Historike	Hamami i Gazi Mehmed Pashës me vjetërsinë dhe origjinalitetin ruajtur deri në ditët e sotme, paraqet një dëshmi të zhvillimeve kulturore dhe arkitekturore gjatë shekullit XVI në Prizren.
Shoqërore	Krahas vlerave historike, teknike dhe estetike, Hamami ka vlerë të madhe shoqërore. Ai përfaqëson vendin ku është mirëmbajtur higjiena personale. Krahas funksionit shërbyes, Hamami ka qenë një vend takim për njerëzit. Edhepse tani ka humbur funksionin origjinal, Hamami vazhdon të jetë një vend takim dhe pikë referuese për komunitetin lokal të Prizrenit. Ka një pozitë qendrore ndërmjet kulturës lindore (Stamboll, Turqi) dhe asaj perëndimore (Vjenë, Austri).
Shkencore	Hamami paraqet një dëshmi faktike për të zhvilluar studime shkencore rreth sistemit të ndërtimit dhe stabilitetit të strukturës ndaj tërmeteve; Një rast studimi për sistemin ujësjellës dhe të kanalizimit gjatë shek. 16; Studim për materialet ndërtimore të qëndrueshme ndaj ndikimeve të ujit dhe motit; Studim për efikasitetin termik brenda ndërtesës. Krahas hulumtimeve teknike shkencore, vetë ndërtesa paraqet një dëshmi për studime dhe hulumtime në fushën e arkeologjisë, kulturës, arkitekturës dhe sociologjisë.
Estetike	Hamami i Prizrenit është njëra prej ndërtesave publike më të dalluara që datojnë nga periudha Osmane. Posedon vlera të larta estetike që përfshin kombinimin e volumeve në eksterier, teknikat kualitative të ndërtimit dhe elemente origjinale të ruajtura në enterier. Vlerat e lartpërmendura e shndërrojnë Hamamin në njërën prej pikave kryesore të referimit në peizazhin kulturor dhe vizual të Prizrenit.

Kulturore	Hamami është simbol i identitetit kulturor dhe fetar; paraqet simbolin e identitet Osman të ndërlidhur me identitetin lokal të Prizreni gjatë shek. 16. Konsiderohet si njëri prej monumenteve kryesore që e identifikojnë qytetin.
Peizazh	Hamami është pjesë e kompleksit të Gazi Mehmed Pashës që përbëhet nga një xhami, tyrbe dhe medreseja (shkolla). Pranë Hamamit gjenden edhe monumentet tjera me rëndësi Xhamia e Emin Pashës, minarja e Xhamisë Arasta, Xhamia e Saraçhanes, Teqja Halveti dhe disa shtëpi tradicionale që datojnë nga shek. 19. Ky kompleks i pasur arkitektonik i shton vlerat monumentit.
Rariteti	Hamami i Gazi Mehmed Pashës është njëri prej hamameve të vetme të tipit të hamameve çift që janë ruajtur në Kosovë*, dhe një prej tri hamameve të këtij tipi të ruajtura në Ballkan.
Edukative	Ndërtesa e Hamamit inkurajon edukim formal dhe joformal në lidhje me teknikat dhe stilet arkitektonike të shek. 16; sistemin e ujësjellësit dhe ngrohjes me ujë; menaxhimi i avullit; në aspektin social mëson mënyrën se si është mirëmbajtur higjiena personale në një banjë publike; menaxhimi i aktivitetit të larjes brenda një sistemi të organizuar nga hyrja në ndërtesë, pritja, përgatitja, pastrimi, tharja e deri në dalje.
Lokale/ komunitetit	Hamami është bërë një simbol shpirtëror dhe kulturor për qytetin dhe rajonin. Ajo lehtëson komunikimin rajonal ndërkulturor për shkak të trashëgimisë së përbashkët; Nga komuniteti i artistëve Hamami konsiderohet si hapësirë kyçe për shfaqje dhe aktivitete artistike, kulturore dhe shoqërore; Duke u bërë adresa kryesore për komunikimin dhe shkëmbimin e përvojave në lidhje me artet dhe veprat artizanale.
Ekonomike	Për 15 vite me radhë Hamami është shfrytëzuar si hapësirë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore. Shfrytëzohet nga komuniteti lokal dhe paraqet një pikë kyçe referente për vizitorët dhe turistët që e vizitojnë qytetin. Rrjedhimisht Hamami posedon një potencial për gjenerim të ardhurave nga turistët dhe shfrytëzimi i hapësirës për organizim të aktiviteteve kulturore. Një menaxhim adekuat dhe brendimi i destinacionit do të krijonte kushte të favorshme për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe ekonomik.

4.2 DEKLARATA E RËNDËSISË

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është bartës i vlerave specifike arkitekturale, historike, kulturore dhe shoqërore për qytetin dhe regjionin. Si një monument nga periudha e hershme Osmane, ai është njëri prej hamameve më të rëndësishme në Evropën Jug-lindore. Specifika kryesore e hamamit është ndërthurja e arkitekturës dhe kulturës Osmane me atë lokale.

I ndërtuar në qendër të qytetit, Hamami për shekuj me radhë ka qenë pjesë e pandashme e jetës së qytetarëve të Prizrenit dhe është shndërruar në simbol shpirtëror dhe kulturore për qytetin dhe regjionin.[10]

[10] Preliminary Technical Assessment of the Architectural and Archaeological Heritage in South East Europe - The Hammam of Gazi Mehmed Pasha Prizren, Kosovo, 2013.

5.1 KORNIZA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE

Trashëgimia Kulturore në Kosovë* menaxhohet nëpërmjet dy niveleve institucionale, qendrore dhe lokale. Në mënyrë që të krijohet një pamje e qartë e mënyrës së funksionimit të institucioneve përgjegjëse për ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore, është hartuar skema e mëposhtme:



Identifikimi, dokumentimi, ruajtja dhe masat ligjore për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës* rregullohet nëpërmjet Ligjit për Trashëgiminë kulturore, i cili është hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me mbështetje të Këshillit të Evropës, dhe është adoptuar në vitin 2006. Ky ligj paraqet mjetin ligjor për përcaktimin e inventarizimit, dokumentimit, përzgjedhjes, ruajtjes, konservimit, restaurimit, administrimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në përputhje me kartat ndërkombëtare. Ky ligj ka për qëllim të thekson skemën organizative të institucioneve kompetente që merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me implementimin e përgjegjësive të cekura në këtë ligj.[11]

Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura – qëllimi kryesor i këtij ligji është ruajtja e monumenteve fetare serbe, si dhe e lokaliteteve historike dhe kulturore me një rëndësi të veçantë për komunitetet që jetojnë në Kosovë*, nëpërmjet themelimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura. Ndikimi politik në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në veçanti e trashëgimisë fetare është evidente në adoptimin e këtij ligji. Njëri prej rekomandimeve të dala nga ky ligj është themelimi i Zonës së Veçantë të mbrojtur të zonës historike të Prizrenit, ku do të përfshihen monumentet

[11] Nora Arapi Krasniqi, Master Thesis "Vernacular Dwellings in Prizren – from Nineteenth-Century Heritage to Twenty-First-Century Challenges", Katholieke Universiteit Leuven, 2012, Leuven, Belgium.

ortodokse, osmane, katolike, vernakulare dhe lokalitetet tjera me rëndësi historike dhe kulturore.

Duke u bazuar në rekomandimet e dala nga ky ligj, në vitin 2012 është adoptuar Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit. Qëllimi i këtij ligji është që të forcojë ruajtjen e natyrës historike të qytetit, duke përcaktuar skema të qarta menaxhimi.

Ashtu si është përshkruar në kapitullin e mbrojtjes ligjore, Hamami i Gazi Mehmed Pashës gjendet në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme dhe dispozitat ligjore të paraqitura në ligjet e lartcekura vlejnë edhe për këtë monument.

5.2 MENAXHIMI I LOKALITETIT

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është pronë e Këshillit Islam të Prizrenit. Kjo ndërtesë menaxhohet nga Qendra Regjionale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, si institucion përgjegjës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në regjion të Prizrenit. Nuk ekziston ndonjë dokument i shkruar që rregullon çështjen e të drejtës së menaxhimit të Hamamit nga QRTK Prizren.

Organizata të shumta, artistë dhe shkrimtarë e shfrytëzojnë herë pas here hapësirat e Hamamit për të organizuar aktivitete kulturore, shoqërore dhe artistike.

Dokufest - e shfrytëzon ndërtesën për organizim të ekspozitës Dokuphoto dhe punëtorive të ndryshme në kuadër të Dokufestit, gjatë muajit Gusht, çdo vjet duke filluar nga viti 2002.

SculpFest – e shfrytëzon ndërtesën për organizimin e Scul'Edu i cili përmban punëtori, debate, ligjërata dhe bisedë artistësh në fillim të muajit Shtator.

Expo Arti – Festivali ndërkombëtar i Karikaturës dhe librave komik është organizuar në hamam që nga viti 2004.

Panairi Kulturor – Gjatë muajit të Ramazanit, panairi kulturore organizohet çdo ditë pas iftarit ku prezantohen ushqimet tradicionale, libra të ndryshëm dhe suvenire.

5.3 PLANIFIKIMI DHE STRATEGJIA QË NDIKON NË LOKALITET

Planifikimi i aktiviteteve zhvillimore lokale, regjionale dhe kombëtare

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është i vendosur në zonën historike të Prizrenit, respektivisht në nën-zonën e pestë: Zona e aksit komercial. Zona historike e Prizreni rregullohet nëpërmjet Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit i cili është adoptuar nga Komuna e Prizrenit në dhjetor 2008, dhe shërben si plan rregullues për këtë zonë.

Ky plan përcakton karakteristikat kryesore të zonës historike të Prizrenit dhe jëp instruksione të qarta dhe udhëzime në lidhje me aktivitetet konservuese dhe zhvilluese të cilat do të duhej të ndërmerren brenda zonës historike.

Udhëzimet për zhvillimin e zonës historike të Prizrenit – versioni punues është hartuar në Mars të vitit 2010. Ky dokument praktik përmban politika në bazë të kritereve dhe udhëzimeve për

dizajn të cilët do të mund të siguronin që zhvillimet brenda zonës historike të Prizrenit po implementohen në mënyrë të saktë dhe të qëndrueshme.

Në kuadër të Implementimit të Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, janë zhvilluar projektet e rigjenerimit urban nga Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me UN Habitatin. Njëri prej projekteve të implementuara ishte "Revitalizimi i rrugës së Farkatarëve". Ky projekt përfshin edhe rrugën që gjendet në anën jugore të oborrit të Hamamit. Qëllimi kryesor i këtij projekti është përmirësimi i ambientit historik urban dhe theksimi i rëndësisë së trashëgimisë kulturore në projektet e rigjenerimit urban.

Në anën tjetër, projekti i restaurimit për Hamamin parasheh renovimin e murit të perimetrit dhe riparimin e gardhit metalik ekzistues në oborr të Hamamit.[12]



Masat e ndërhyrjes të propozuara për oborr të Hamamit[13]

[12] Jusuf Xhibo, Fikret Tikves, Besart D., Nehari T, Kadër V., *GMP Restoration- Interventions - Situation*, IPM Pz, 2011, Prizren.

Instrumentet tjera planifikuese dhe dokumentet strategjike relevante për lokalitetin

Strategjia për Kulturë dhe Zhvillim të Turizmit është duke u hartuar nga një grup punues i përbërë nga përfaqësues të Komunës së Prizrenit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe profesionistë.

Në momentin e hartimit të Planit të Menaxhimit për Hamamin e Gazi Mehmed Pashës, kjo strategji në hartim të sipërm është në fazën e dokumentit punues dhe nuk është i hapur për publikun.

5.4 SHFRYTËZIMI I LOKALITETIT NË TË KALUARËN DHE SOT

Nga viti i ndërtimit e deri më sot, Hamami i Gazi Mehmed Pashës ka pasur funksione të ndryshme.

Vitet 1563/4 – 1914 – ka funksionuar si banjë publike me pjesë të ndara për shfrytëzim nga meshkujt dhe femrat.

1914– Pjesa për femra është mbyllur për shfrytëzim si hamam, përderisa pjesa e meshkujve ka vazhduar së funksionuari.

Deri 1936 – Pjesa e meshkujve ka funksionuar si banjë publike.

1944 – 1954 – Pjesa e femrave është shfrytëzuar si hapësirë për punëtorinë e prodhimit të djathit, e më pas si depo.

1954 – 1981 – Hamami është shpallur monument nën mbrojtje të shtetit, që ka mundësuar realizimin e punëve restauruese dhe mirëmbajtëse.

1981 – 1999 – Hamami është lënë në mëshirë të kohës, pa ndonjë funksion apo mirëmbajtje.

2001– Pastrimi i hamamit dhe kalimi nën menaxhim të Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturore në Prizren.

2001 – Tash – Organizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore, artistike në hapësirat e Hamamit. Gjatë këtyre viteve në hamam janë organizuar aktivitetet si ekspozita artistike, ekspozita etnografike, debate, promovime të librit, koncerte të muzikës kalsike

5.5 GJENDJA & KONSERVIMI I LOKALITETIT

Ndërtesa e Hamamit është në gjendje të keqe fizike dhe në rrezik për dëmtim të mëtejmë. Mungesa e riparimeve dhe mirëmbajtjes së kulmit, me ç'rast një pjesë e madhe e mbulesës është larguar apo vjedhur, ka shkaktuar dëme të vazhdueshme në strukturën e ndërtesës, ku lagështia dhe rritja e bimësisë kanë bërë efektin e tyre.

Në vitin 2010, është hartuar Plani i Restaurimit nga ekipi i ekspertëve lokal nën mbikëqyrjen e ekspertes nga Turqia, Prof. Dr. Zeynep Ahunbay.

[13] Jusuf Xhibo, Fikret Tikves, Besart D., Nehari T, Kadër V., *GMP Restoration – Interventions - Situation* IPM Pz, 2011, Prizren.

Faza e parë e restaurimit është financuar nga qeveria Turke nëpërmjet UNESCO-s, Zyra në Sarajevë. Faza e parë ka përfshirë ndërhyrjet urgjente në Hamam në mënyrë që të sigurohet ndërtesa nga dëmtimet e mëtejme. Punët restauruese kanë filluar në vitin 2013 dhe janë ende në vazhdim. Punët e kryera gjatë kësaj faze janë si në vijim:

- Largimi i shtresave të intervenimeve jo adekuate të bëra gjatë viteve 1960ta;
- Rikonstruimi i pjesshëm i kupolave të dëmtuara;
- Restaurimi dhe riparimi i plasaritjeve dhe dëmtimeve tjera strukturale në kupola dhe qemerë duke shfrytëzuar teknikat moderne;
- Vendosja e qeramidheve të ngjashme me ato origjinale në kupolat që mbulojnë pjesën e ftohtë;
- Vendosja e mbulesës nga plumbi mbi kupolat që mbulojnë pjesën e nxehtë dhe atë teknike;

Për shkak të harxhimeve të paparashikueshme, sikurse rekonstruimi i dy kupolave mbi pjesën e ngrohtë, fondi i siguruar nuk ka mjaftuar për përmbylljen e fazës së parë të restaurimit.

Krahas përfundimit të fazës së parë të restaurimit, nevojiten fonde shtesë për të siguruar ruajtjen dhe konsolidimin e strukturës, të pasuar me adaptimin për të akomoduar funksionet e reja të propozuara.

5.6 SIGURIA

Ndërhyrjet restauruese janë duke u zhvilluar në Hamam që nga viti 2013. Përderisa janë duke u zhvilluar punimet, lokaliteti nuk ofron kushte të favorshme për siguri, për të mundësuar organizimin e aktiviteteve kulturore të lartpërmendura ose për tu vizituar nga turistët.

Në kuadër të Planit të restaurimit parashihet vendosja e masave të sigurisë në Hamam. Plani parasheh instalimin e detektorëve të zjarrit, kamerat e sigurisë dhe dritat emergjente.

Krahas aktiviteteve të planifikuara, daljet emergjente në rast të zjarrit apo fatkeqësive natyrore duhet të parashihen dhe të shënjohen brenda ndërtesës.

5.7 PREZANTIMI DHE INTERPRETIMI I LOKALITETIT

Tabelat informuese para ndërtesës me të dhëna rreth vitit të ndërtimit, historisë dhe atributeve, mungon.

Në qytet janë vendosur 10 tabela informuese me informata kryesore rreth monumenteve. Në njërën prej tabelave të vendosura pranë Urës së Gurit, rreth 200 metra në jug të Hamamit, është paraqitur Hamami me një përshkrim të shkurtër dhe një pamje e saj.

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është prezantuar dhe promovuar në udhërrëfyes turistik për Prizrenin.

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj ku Hamami është prezantuar nëpër udhërrëfyes:

www.prizren360.com – është ueb faqe zyrtare e zhvilluar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, me informata relevante rreth Prizrenit, monumenteve, aktiviteteve, akomodimit dhe shërbimeve të ofruara.

Hamami si njëri prej monumenteve referente të qytetit është prezantuar me nj përshkrim të shkurtër dhe fotografitë e eksterierit dhe enterierit.



www.inyourpocket.com/kosovo/prizren - është një kompani ndërkombëtare për zhvillim të udhërrëfyesve turistik, e cila e ka përfshirë edhe Prizrenin në hartën e destinimeve të promovuar. Udhërrëfyesi *Prizren In Your Pocket* është prodhuar në format të shtypur dhe elektronik në vitin 2010. Hamami gjithashtu prezantohet nëpërmjet një përshkrimi të shkurtër, disa fotografi dhe një numër kontakti për organizim të vizitave.



5.8 EDUKIMI

Informatat gjenerale rreth monumenteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës* prezantohen në kuadër të kurrikulës kombëtare për edukim fillor, sekondar dhe atë të lartë të mesëm. Por prezantimi i monumenteve specifike, sikurse Hamami i Gazi Mehmed Pashës apo monumenteve tjera në Prizren apo Kosovë* mungon.

5.9 HULUMTIMI

Hulumtimet e bëra rreth Hamamit janë bazuar në një dokumentacion të shkruar shumë të rëndësishëm që ka shërbyer si bazë e informatave:

Burimet e shkruara:

- Raportet e vitit 1959 - 1965 për dokumentimin e gjendjes aktuale dhe punimet restauruese-konservuese: Ing. Arch. HusrefRexhiq; Arch. Ivan Zdravkoviq; Prof. AleksandarDeroko.
- Studimi mbi vlerësimin e trashëgimisë kulturore në Prizren, Enti i Urbanizmit dhe Ruajtjes së Monumenteve Kulturore dhe Rariteteve natyrore/ sot QRTK Pz/, Prizren, mars, 1970.
- Fotografitë e realizuara gjatë viteve 1960 deri sot 2014.
- Dokumentimi i gjendjes aktuale të ndërtesës, 1998 (IMMK – IMM, Prizren).
- Gjendja aktuale dhe projekti i restaurimit i hartuar nga ekipi profesional i Institutit për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren: Prof. Dr.ZeynepAhunbay, Ing. Arch. JusufXhibo, Ing. Arch. FikretTikvesh, B.Arch. BesartDajçi, Ing. Arch. NehariToçilla, Ing. Arch. KadërVogël, 2011.
- Tema e magjistraturës e hartuar nga ing. JusufXhibo, "Hamamet e Prizrenit – Një vështrim historiko-arkitektonik", Qendra për Studime Albanologjike, Tiranë, Shqipëri, 2014.

Bibliografia:

- Muhamed Shukriu, Prizreni Antik – Morfologji e Konceptit për Mbrojtjen e Kulturës Materiale, Prizren 2001.
- Raif Vërmica, Kosovo*'da Osmanli Mimari Eserleri I, Ankara 1999.
- Serafin Nikoliç, Prizren od Srednjeg Veka do Savremenog Doba, Prizren 1998.
- Esat Haskuka, Historijsko-geografska Analiza Urbanih Funksija Prizrena, Visa Pedagoska Skola Bajram Curri, Gjakovë, 1985.
- Hasan Kaleshi, Shënime nga e Kaluemja e Prizrenit gjatë PeriudhësTurke. Përparimi, 7-8, Prishtinë, 1961.

5.10 VLERËSIMI I MENAXHIMIT DHE QASJA E VIZITORËVE

Në bazë të regjistrit të Qendrës Regjionale për trashëgimi Kulturore në Prizren, hapësira e Hamamit kryesisht shfrytëzohet për organizim të aktiviteteve kulturore nga organizatat lokale dhe ato ndërkombëtare. Aktivitetet më të shpeshta të organizuara në Hamam përfshijnë ekspozitat artistike, punëtoritë, promovimet e librave dhe koncertet.

Krahas aktiviteteve të zhvilluara, Hamami është njëri prej monumenteve kyç në zonën historike të Prizrenit dhe vizitohet nga delegacionet e shumta që janë organizuar. Gjatë viteve 2012-13, 22 vizita nga delegacionet kombëtare dhe ndërkombëtare janë organizuar. Por numri i saktë i vizitorëve nuk është regjistruar.

Aktivitetet e organizuara në Hamam gjatë viteve 2012 dhe 2013 janë prezantuar më poshtë:[14]

[14] Medihe Fishekçiu, Annual Report on Activities organized in the Gazi Mehmed Pasha Hammam, Regional Centre for Cultural Heritage in Prizren, 2012 – 2013, Prizren, Kosovo.

Viti 2012



Viti 2013



Nga nëntori i vitit 2013 kanë filluar ndërhyrjet restauruese në Hamam, dhe rrjedhimisht aktivitetet e organizuara janë kufizuar.

5.11 VLERËSIMI I PËRFSHIRJES SË KOMUNITETIT DHE MARDHËNIET

Hamami i Gazi Mehmet Pashës paraqet ndërtesën publike kryesore gjithëpërfshirëse të të gjitha komuniteteve që jetojnë dhe veprojnë në regjionin e Prizrenit. Duke u bazuar në gamën e gjerë të aktiviteteve të zhvilluara në Hamam nga komunitetet që jetojnë në Prizren: shqiptarë, boshnjak, turk dhe sektorë të ndryshëm sikurse: artistët, humanitarët, shkrimtarët, shoqëria civile, mund të konkludojmë se kjo ndërtesë është e lidhur ngushtë me komunitetit duke u bërë një pjesë e pandashme e jetës kulturore dhe shoqërore të Prizrenit.

Vlerësimi i ofertës turistike

Prizreni paraqet njërin prej pikave më të dalluara të sektorit të turizmit në Kosovë*. Trashëgimia e saj e pasur kulturore dhe natyrore paraqet një potencial për zhvillim të turizmit kulturor.

Hamami i Gazi Mehmed Pashës si njëri prej pikave referente të qytetit paraqet njërin prej monumenteve kyçe në itinerarin e vizitave të turistëve.

Kosovo* Guide është një operator turistik që operon në Kosovë* dhe ofron informata gjithëpërfshirëse për vizitorët e Kosovës*. Në kuadër të turneve dhe destinimeve të ofruara nga ky operator, zë vend edhe Prizreni dhe Hamami i Gazi Mehmed Pashës. Organizohen turne 2 - 3 ditore që ofrojnë vizita në vendet më karakteristike të Prizrenit, përfshirë këtu edhe Hamamin:

- Përjeto Prishtinën & Prizrenin - Turne 3 ditore
- Doku Tur 18-24 Gusht 2014 – Turne ditore në Prizren
- Prizren, Dragash dhe Brod – Turne 3 ditore
- Prizreni & Veraritë e Rahovecit – Turne 2 ditore



http://www.kosovoguide.com/?cid=2,166,207&view=all

Krahas faktit që ekzistojnë oferta të shumta turistike të ofruara nga institucionet lokale dhe qendrore, si dhe nga kompanitë private që organizojnë vizita në monumentet kryesore të Prizrenit, nuk ekzistojnë statistika rreth numrit të vizitorëve që kanë vizituar qytetin gjatë këtyre viteve të kaluara.

5.12 VLERËSIMI I KOMUNIKIMIT DHE MARKETINGUT

Për aktivitetet e zhvilluara në Hamam nuk është hartuar ndonjë program për marketing dhe promovim. Aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit bëhen ad-hock duke plotësuar nevojat e OJQ-ve përkatëse dhe komunitetit që jeton dhe vepron në Prizren.

Brednimi dhe zhvillimi i një kampanje profesionale të marketingut dhe promovimit janë veprime të nevojshme që duhet të përfshihen në Planin e Veprimit të Hamamit.

5.13 POTENCIALI DHE PËRFITIME EKONOMIKE DHE SOCIALE

Hamami mund të shfrytëzohet për organizimin e aktiviteteve kulturore në nivel regjional dhe më gjerë, si dhe për aktivitete biznesi dhe prezantim të trashëgimisë jo-materiale, sikurse janë punimet artizanale. Një pjesë mund të shfrytëzohet si muze për ekspozimin e prodhimeve

artizanale dhe zejeve që janë në zhdukje e sipër (punimi i filigranit, farkëtarisë, gërshërë-bërësit, qeleshe-punuesit etj.), dhe shitja e tyre. Në këtë mënyrë do të mundësohej zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe gjenerimi i përfitimeve ekonomike.

Shfrytëzimi kulturor dhe ekonomik mundëson që Hamami të shndërrohet në një pikë takim social duke promovuar kulturë, mundësuar punësim dhe njëkohësisht duke zhvilluar turizmin dhe tregtinë.

5.14 VLERËSIMI I FAKTORËVE, EFEKTEVE DHE RREZIQEVE QË NDIKOJNË NË TRASHËGIMI

Faktorët natyrorë – Faktorët kryesorë që dëmtojnë monumentin janë shiu dhe lagështia, të cilët kanë depërtuar në ndërtesë. Ndërtesa është dëmtuar edhe nga vegjetacioni i cili ka mbuluar sipërfaqen e mureve. Këto rreziqe natyrore janë të konsiderueshme.

Faktori njeri - Rritja e numrit të popullsisë dhe shfrytëzimet ilegale të zonës afër Hamamit dëmton dhe degradon integritetin ambiental të monumentit. Mungon mirëmbajtja, shenjat për orientim të vizitorëve dhe materiali informues.

Trafiku – Hamami është i vendosur pranë një rruge me trafik të dendur, që paraqet kërcënim nga ajri i ndotur dhe dridhjet e shkaktuara në tokë.

ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një mjet për vlerësimin e situatës ekzistuese, që përdoret për të mbledhur ide dhe propozime nga përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, të cilët marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit.

Strengths (Përparësitë) – atributet pozitive të brendshme të Hamamit të Gazi Mehmet Pashës.

Weaknesses (Dobësitë) – atributet negative të brendshme të Hamamit të Gazi Mehmet Pashës.

Opportunities (Mundësitë) – faktorët e jashtëm që mund të kontribuojnë në përmirësimin e situatës në Hamamin e Gazi Mehmet Pashës.

Threats (Kërcënimet) – faktorët e jashtëm që mund të rrezikojnë dhe përkeqësojnë situatën në në Hamamin e Gazi Mehmet Pashës.

Rezultatet e mëposhtme janë identifikuar, diskutuar dhe pajtuar me palët e interesit gjatë Punëtorive I dhe II dhe procesit të hartimit të planit të menaxhimit.

<u>SWOT analiza – përparësitë</u>

- Hamami i Gazi Mehmet Pashës është monument i mbrojtur me ligj që nga viti 1954 dhe gjendet në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme. Numri i mbrojtjes: 380/54, numri unik në databazë 000437.
- Hamami i Gazi Mehmet Pashës që nga viti 2003 gjendet në Listën e Prioriteteve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – fakt ky që ndikon në lehtësimin për përfitimin e fondeve nacionale dhe internacionale për rehabilitim, restaurim dhe revitalizim të monumentit.
- Për monumentin janë hartuar dokumentet teknike të kornizës së projektit Procesi i Lubjanës: ID – Karta Identifikuese, PTA – Vlerësimi Teknik Preliminar dhe FS – Studim i Fizibilitetit.
- Donacioni i siguruar nga shteti i Turqisë, nëpërmjet UNESCO-s, në vlerë prej 300.000 $ për restaurim të Hamamit.
- Projekti i restaurimit i hartuar nga ekspertët lokal të Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, nën mbikëqyrjen e prof. Dr. Zeynep Ahunbay.
- Nga viti 2013 kanë filluar punët restauruese, që do të ndikojnë në ndërprerjen e dëmtimeve të mëtejme.
- Ruajtja e vlerës së autenticitetit të një pjese dërmuese të objektit.
- Hapësirat e ruajtura të Hamamit që mund të shfrytëzohen për prezantimin e pjesëve funksionale të banjës publike të shekujve 16-19, ndarja e hapësirave për shfrytëzim nga femrat dhe meshkujt, fontanat nga mermeri, rrjeti i ujësjellësit etj.
- Hamami i Gazi Mehmet Pashës paraqet një pikë të rëndësishme referimi për popullsinë që jeton në Prizren dhe më gjerë.
- Atraksion turistik për vizitorët e qytetit.

- Lokacion ku zhvillohen ngjarje të ndryshme artistike dhe kulturore: ekspozita, promovime të librave, tryeza të rrumbullakët, koncerte të vogla akustike.

SWOT analiza – dobësitë

- Gjendja e rëndë fizike e monumentit nga dëmtimet e shkaktuara nga koha dhe mungesa e mirëmbajtjes.
- Mungesa e një trupi udhëheqës që do të menaxhojë aktivitetet në monument, dhe do të sigurojë mirëmbajtjen e objektit.
- Mungesa e një roje që do të mbronte ndërtesën nga veprimet vandale.
- Mungesa e një plani të menaxhimit që do të përcaktojë në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë veprimet që mund të ndërmerren në Hamam.
- Mungesa e një plani të mirëmbajtjes.
- Mungesa e qasjes gjithëpërfshirëse, për personat me nevoja të veçanta, në monument: pjerrinat, sinjalet akustike, shenjëzimet në tokë për të verbrit etj.
- Mungesa e hapësirave të nevojshme për funksionimin e ndërtesës si qendër për zhvillime të aktiviteteve kulturore, artistike, e edukative; Mungesa e nyjeve sanitare.
- Mungesa e një tabele informuese të historikut të monumentit.

SWOT analiza – mundësitë

- Plani i Konservimit dhe i Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit – e trajton monumentin edhe në aspektin e planifikimit hapësinor.
- Monumentet tjera me rëndësi të madhe historike-artistike, sikurse: Xhamia e Saraçhanes, Teqja e Halvetive, Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Tyrbja e Gazi Mehmet Pashës, xhamia e Emin Pashës, Minarja e Xhamisë Arasta, shtëpitë e vjetra tradicionale, që krijojnë një ansambël artistik të vlerave të trashëgimisë kulturore në Prizren.
- Zhvillimi i projekteve revitalizuese nga Komuna e Prizrenit dhe UNHabitat, në hapësirën rreth Hamamit: Revitalizimi i rrugës "Farkëtarët", dhe Revitalizimi i sheshit të Lidhjes – projekt në zhvillim e sipër. Mundësi e ridefinimit urban në favor të zhvillimit të trashëgimisë kulturore me potenciale turistike duke krijuar lidhje në mes të rrugës se Farkatarëve dhe sheshit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit
- Mundësia për zhvillimin e projekteve revitalizuese në hapësirat tjera përreth, sikurse: Hapësira publike rreth Minares Arasta, që do të rriste kualitetin urbanistik të hapësirës duke krijuar kushte për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.
- Projekt i financuar nga Komuna e Prizrenit, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm për Ndriçimin e Monumenteve. Përfitues I këtij projekti është edhe Hamami. Projekt në vlerë prej 20.000 €.
- Mundësia e shfrytëzimit të kësaj hapësire për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme zejtare, artizanale, edukative, kulturore dhe artistike, që do të kontribuonte në zhvillim të qëndrueshëm të Monumentit si dhe në ngritjen e vetëdijes së komunitetit rreth vlerave të tij.

- Festivale të shumta që organizohen në Prizren gjatë vitit, aktivitetet e të cilave mund të organizohen në hapësirat e Hamamit.
- Bashkërenditja e aktiviteteve të ndryshme kulturore, artistike, edukative dhe zejtare për të krijuar kushte për tërheqjen e turistëve dhe shndërrimin e Hamamit në një pikë referente për vizitorët.

SWOT analiza – kërcënimet

- Fondet e siguruara nga UNESCO për restaurim të Hamamit, të pamjaftueshme për përfundim të fazës së parë të projektit dhe restaurim të tërësishëm të ndërtesës.
- Problemet rreth përgjegjësive ligjore në lidhje me çështjen e pronësisë së Hamamit.
- Mungesa e zonës së definuar mbrojtëse rreth Hamamit.
- Veprimet vandale nga grupe individësh – largimi i plumbit nga kupolat e Hamamit, thyerja e xhamave në kupola.
- Mbeturinat e hedhura nga kalimtarët, si dhe mbeturinat e lëna nga grupe njerëzish që e shfrytëzojnë objektin për realizimin e aktiviteteve të tyre në Hamam.
- Uzurpimi i hapësirës së oborrit të Hamamit nga një pronar privat.
- Degradimi i vlerave të Hamamit nga përdorimi i pakujdesshëm.
- Niveli i ulët i vetëdijesimit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore
- Pozicionimi i Hamamit pranë një aksi me qarkullim të dendur, gjë që e ekspozon atë ndaj rreziqeve lidhur me ajrin e ndotur dhe vibrimeve të shkaktuara.

VIZIONI DHE PARIMET

7.1 DEKLARATA E VIZIONIT

HAMAMI, PËR ÇDO DISPONIM, PËR ÇDO MOSHË, PËR ÇDO STINË, PËR ÇDO VEND.

Hamami i Gazi Mehmed Pashës do **të vazhdojë të shquhet lokalisht dhe rajonalisht** si bartës i **vlerave të mëdha arkitekturore, historike, artistike, sociale dhe edukative**. Kjo gjë do të mundësohet nga një **qasje e integruar** ndaj **konservimit të elementëve kulturorë dhe arkitektonikë**, **përmirësimit të qasjes së publikut e interpretimit** dhe ndaj **mundësive për zhvillim lokal dhe të komunitetit**.

Hamami do të gëzojë **mirëmbajtje të standarteve më të larta** dhe **mbrojtje të plotë**, në mënyrë që të jetë i mbrojtur nga rreziqet potenciale. Ai do të përfitojë gjithashtu nga një **qasje bashkëpunuese** nga ana e palëve kyçe të interesit që të mundësohet kështu një **menaxhim i integruar dhe gjithëpërshirës**.

Ky vizion do të mbështetet te një **strukturë menaxhuese** që do të ketë fuqi vendimarrjeje për çështje të **konservimit të integruar dhe menaxhimit**, do të **mbështesë nevojat në terren**, do të **ndërlidhet me vizitorët, palët e interesit dhe komunitetin vendas**, duke punuar me një frymë bashkëpunimi.

7.2 PARIMET UDHËZUESE

Menaxhimi i Hamamit të Gazi Mehmed Pashës do të lehtësohet falë përcaktimit të parimeve udhëzuese. Këto parime udhëzuese janë konceptuar që të jenë të vlefshëm në kohë dhe që të jenë relevantë dhe për rishikimet e mëtejshëm të Planit të Menaxhimit. Çdo veprim i ndërmarrë në Hamam duhet të përmbushë këto parime, për tu siguruar që ata përputhen me frymën e këtij Plani Menaxhimi dhe që ata kanë në thelbin e tyre mbrojtjen dhe konservimin e Hamamit :

I. Çdo vendim dhe veprim në lokacion do të udhëhiqet nga nevoja për konservim të cilësisë së lartë, transparent dhe të mirëmenduar të vlerave dhe kuptimeve të Hamamit

II. Plani i menaxhimit, vizioni, parimet udhëzuese dhe objektivat do të përbëjnë bazën mbi të cilët do të ndërtohet çdo plan, politikë a vendim që lidhet me Hamamin

III. Menaxhimi i Hamamit do të synojë përforcimin e qasshmërisë së tij, përfshirë eliminimin e arsyeshëm dhe realist të çdo pengese fizike, intelektuale, sociale, kulturore dhe organizative ndaj qasshmërisë së tij.

IV. Menaxhimi i Hamamit do të promovojë dhe do të rrisë mirëkuptimin dhe njohuritë e të gjithëve mbi lokacionin, vlerat dhe kuptimet e tij.

V. Menaxhimi i konservimit të lokacionit do të ndërthuret me mundësitë e zhvillimit të turizmit dhe të zhvillimit lokal e të komunitetit.

VI. Hamami do të menaxhohet nëpërmjet një partneriteti aktiv dhe qartësisht të formuluar mes palëve kyçe të interesit.

OBJEKTIVAT PËR PËRDORIMIN, MBROJTJEN DHE KOMUNIKIMIN RRETH LOKALITETIT

8.1 QËLLIMET KRZESORE LIDHUR ME PLANIN E MENAXHIMIT TË HAMAMIT TË GAZI MEHMED PASHËS

Plani i Menaxhimit të një lokaliteti të trashëgimisë është një instrument qendror i pranuar ndërkombëtarisht për një planifikim, konservim, hulumtim, prezantim dhe shfrytëzim unik të trashëgimisë kulturore të palëvizshme. Plani i Menaxhimit merr në konsideratë dhe integron të gjitha dokumentet ekzistuese strategjike dhe planifikuese, duke filluar nga planifikimi urban, gjurmimet arkeologjike dhe plani i konservimit, e deri tek strategjitë lokale dhe kombëtare për edukim, kulturë, shkence, zhvillim regjional dhe turizëm.

Karakteristikat kryesore të këtij dokumenti janë zbatimi i qasjeve me pjesëmarrje të gjërë, përfshirja përkatëse e palëve të interesit, një trajtimi këndgjerë i vlerave të trashëgimisë dhe rëndësia e njëjtë që u kushtohet ruajtjes dhe përdorimit të trashëgimisë.

Objektivat e përgjithshëm të Planit të Menaxhimit janë:

1. Krijimi i një vizioni dhe një kornize strategjike (strategjitë, metodat, mjetet, veprimet dhe projektet, burimet dhe koha) për të mbështetur dhe përforcuar vlerat e objektit gjatë 5 viteve të ardhshme, në përputhje me parimet dhe marrëveshjet ndërkombëtare si dhe kontekstin vendor,
2. Inkurajimi i zhvillimit të qëndrueshëm, të mirëmenduar dhe të përgjegjshëm duke vendosur ekuilibër mes mbrojtjes dhe përdorimit të trashëgimisë (përfshirë konservimin, qasjen, zhvillimin urban dhe atë turistik, etj.),
3. Zhvillimi i sinergjisë ndërsektoriale të bazuar në dialog, bashkëpunim dhe ndarjen e qartë të roleve dhe përgjegjësive mes palëve të interesit,
4. Sigurimi i mbrojtjes përfshirëse të trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes udhëzimeve të vazhdueshme dhe mbikqyrjes së zhvillimit lokal urban,
5. Inkurajimi i shpirtit të ndërmarrjes, efektshmërisë, zhvillimit ekonomik dhe rritjes së të ardhurave që gjenerohen nga objekti i trashëgimisë
6. Mundësimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës përmes komunikimit dhe bashkëpunimit mes palëve të ndryshme të interesit,
7. Sigurimi i zbatimit të efektshëm të ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve respektive të planifikimit dhe sigurimi i rehabilitimit të objektit të trashëgimisë.

Objektivat specifikë për Planin e Menaxhimit të Hamamit të Gazi Mehmed Pashës janë:

4.2.1 Të jap kontribut në zhvillimin lokal ekonomik dhe në mirëqenien e komunitetit,
4.2.2 Të promovojë vlerat historike, artistike, shoqërore, shkencore dhe edukative dhe të ngrit vetëdijen e publikut rreth këtyre vlerave,
4.2.3 Të integrojë monumentin me vlerat dhe potencialin turistik dhe të përcaktojë mundësitë,

4.2.4 Të hartojë një plan veprimi, një program të mirëmbajtjes, si dhe një udhëzues për rregulloren e brendshme për monumentin,
4.2.5 Qartësimi i çështjeve pronësore-juridike, të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes,
4.2.6 Përfshirja e Hamamit si pjesë e një ansambli më të madh, dhe në përputhje me planet strategjike lokale si për shembull Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit.

Shënim*:*

Objektivat specifikë 4.2.5 dhe 4.2.6 u identifikuan nga palët e interesit gjatë punëtorisë I.

Dy propozime të tjera kërkonin të plotësonin prioriteter 4.2.2 dhe 4.2.4 si më poshtë (elementët e plotësuara janë të nënvizuar):

4.2.2 Të promovojë vlerat historike, artistike, shoqërore, shkencore dhe edukative dhe të ngrit vetëdijen e publikut rreth këtyre vlerave,

4.2.4 Të hartojë një plan veprimi, një program të mirëmbajtjes, si dhe një udhëzues për rregulloren e brendshme për monumentin.

FUSHAT SPECIFIKE PËR NDËRHYRJE DHE VEPRIM

9.1 ÇËSHTJET ORGANIZATIVE TË MENAXHIMIT DHE TË VENDIMARRJES

Zbatimi i Planit mbi bazën e bashkëpunimit mes palëve

Palët që punuan së bashku për përpilimin e Planit të Menaxhimit për Hamamin e Gazi Mehmed Pashës, duhet që të vazhdojnë bashkarisht për zbatimin e synimevet dhe objektivave të tij, për të mundësuar kështu ruajtjen e vlerave dhe kuptimeve për brezat e ardhshëm.

Zbatimi i objektivave të Planit të Menaxhimit kërkon mbështetjen dhe pjesëmarrjen jo vetëm të këtyre palëve por edhe të strukturave të tjera, individë apo organizma financues. Plani i Menaxhimit në vetvete mund të ofrojë një bërthamë koordinuese për të gjitha përpjekjet, por ai kërkon gjithashtu një nivel të lartë angazhimi të vazhdueshëm dhe resurse për zbatimin e tij.

Propozimi i Bordit Menaxhues

Më datë 9 Tetor 2014 (punëtoria III) u arrit konsensusi mbi nevojën për t'ja besuar zbatimin e Planit të Menaxhimit një strukture të përbërë nga palët kyçe të interesit. Edhe pse këndvështrimet për përberjen e strukturës ishin të shumë të ndryshme, palët ranë dakord për funksionet kyçe që duhet të përfaqësohen në Bord, duke marrë parasysh këtu nevojat e Planit të Menaxhimit. **Akordi për emrat specifikë që do të përbënin strukturën ende nuk është arritur.**

<u>Lista e akronimeve të përdorura:</u>

MKRS: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
QRTK-P: Qendra Rajonale për Trashëgiminë Kulturore – Prizren
DUPH: Departmenti i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
DKRS: Departmenti për Kulturë, Rini dhe Sport
DZHET: Departmenti për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm
RRoK: Rrjeti i Organizatave të Kulturës
ZES : Shoqatat e "Zejatarëve", "Esnafëve " dhe "Sofra "
FILIGRAN: shoqatë artizanale vendore


BORDI M ES
Niveli q
Niveli vendor
Niveli vendor – Zona Historike e Prizrenit
Pronari ligjor
Shoqëria civile
Komuniteti i biznesit
Komuniteti lokal
MKRS /
Komuna Prizren (DUPH/DKRS/DZHET)
Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit
Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren
RRoK ose DokuFest
Shoqata ZES ose Shoqata e Turizmit ose Filigran
Një përfaqësues i banorëve të lagjes

Themelimi i Bordit Menaxhues

Prania e Bordit Menaxhues përfaqëson një angazhim afatgjatë nga anëtarët e tij për konservimin dhe përmirësimin e lokacionit të Hamamit.

Bordi Menaxhues themelohet nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

Bordi menaxhues formohet duke u bazuar në një Memorandum Mirëkuptimi midis të gjithë institucioneve/strukturave/individëve anëtarë. MM përcakton rolet, detyrimet reciproke dhe të drejtat dhe funksionimin e Bordit.

Roli i Bordit Menaxhues

Anëtarët e Bordit Menaxhues kanë një rol kyç në sjelljen në jetë të Planit të Menaxhimit.

Ata duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e ndjenjës së pronësisë dhe mbështetjen për objektivat e Planit përmes të gjithë përdoruesve të lokacionit, dhe atyre që mund të preken nga Plani.

Është një përgjegjësi e Tyre ta promovojnë Planin kundrejt financuesve të mundshëm, të ngrejnë fondet e nevojshme për të zgjidhur çështjet kyçe të ngritura në Plan.

9.2 MBROJTJA E LOKALITETIT

Konservimi, Masat dhe standartet për mbrojtjen fizike dhe vlerat e lokalitetit

Përtej aktivteteve të konservimit dhe restaurimit që u ndërmorrën gjatë fazes së pare të punëve restauruese, duhen bërë punë shtesë për të kompletuar proçesin e restaurimit të lokacionit.

Duke u bazuar në planin e restaurimit, hapat e parashikuara të zbatohen gjatë fazës së dytë të restaurimit janë si më poshtë:

- Rindërtimi i shkallës në pjesën e grave
- Restaurim i pjesëve të brendshme të mureve dhe suvasë së brendshme
- Riparim i dyshemeve dhe tavaneve
- Punime të brëndshme që nevojiten për funksionin e ri: konservim dhe restaurim i elementeve origjinalë të interierit; vendosja e paneleve ekspozues.
- Vendosja e dyerve dhe dritareve
- Instalimet elektrike dhe instalimi i përçuesit të energjisë
- Furnizimi me ujë, kanalizimet e ujrave të zeza dhe rihapja e sistemit të drenazhimit
- Sistemi kundër zjarrit dhe masat e sigurisë
- Rregullime të peizazhit të oborrit të Hamamit.

Aksionet e planifikuara synojnë të sigurojnë konservimin dhe ruajtjen e aspekteve fizikë dhe vlerave të Hamamit në Prizren.

Paraqitja grafike e punëve restauruese të planifikuara mund të shihet në **Aneksin 2**.

Përdorimet e lokalitetit

Duke u bazuar në gjendjen ekzistues dhe në fushat kyçe të listuara në Termat e references, një listë objektivash që janë diskutuar me palët e interesit. Për çdo synim, shifra romake (I,II, III,...) përkon me objektivat specifike të listuar në Kapitullin VII. Shifra e dytë (1,2,3,...) korrespondon me synimet e ndryshme brënda së njëjtit objektiv.

Për një panoramë të plotë të tabelës dhe veprimeve përkatëse për tu ndërmarrë, lutemi ti referoheni *Kapitullit XI (Plani i Veprimit, përfshirë afatin kohor, prioritetet, resurset dhe indikatorët).*

	ASPEKTET	Korniza ligjore	Mbrojtja	Hulumtimi dhe edukimi	Prezantimi dhe interpretimi i lokacionit	Menaxhimi dhe siguria	Përfshirja e komunitetit	Marketingu dhe komunikimi	Zhvillimi Turistik	Zhvillimi ekonomik
SYNIMET	**I.1 Ngritja e një sistemi hulumtimi për grumbullim fondesh në shërbim të Hamamit**		x		x					x
	I.2 Rritja e aftësive koordinuese dhe mirëpritëse të aktiviteteve kulturorore në Hamam				x	x	x	x		
	I.3 Ofrimi i më shumë mundësive përjetimi nga komuniteti vendas dhe turistët						x		x	x
	I.4 Forcimi i kapaciteve vetë-financuese për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtejshëm		x		x					
	II.1 Zhvillimi i infrastrukturës që do ti mundësojë vizitorëve një vizitë interesante dhe të sigurtë				x	x			x	x
	II.2 Rritja e qasmërishë dhe frekuentimit nga të gjithë			x			x			
	II.3 Hapja ndaj publikut më të afërt			x	x		x			
	II.4 Promovimi dhe theksimi i vlerave edukative/shkenco re të Hamamit			x	x					
	III.1 Përforcimi i kapaciteteve promovuese dhe të marketingut të Hamamit si një ikonë e rëndësishme kulturore				x			x	x	x

SYNIMET	**III.2 Rritja e pranisë së Hamamit në tregun e ofertave turistike**				x				x	x
	IV.1 Përmirësimi i bazës rregullative mbi të cilën do të mbështetet funskionimi i Hamamit		x			x				
	IV.2 Ngritja e kapaciteteve bazë të administrimit të vizitorëve					x		x		x
	IV.3 Ngritja një stafi të përgjegjshëm dhe efektiv		x			x				
	V.1 Sqarimi i bazës rregullative mbi të cilin do të bazohet zbatimi i Planit të Menaxhimit	x				x				
	V.2 Ngritja e një sistemi menaxhimit bazuar mbi frymën e bashkëpunimit mes palëve kyçe të interesit	x				x				
	VI.1 Përmirësimi i kuptimit nga publiku i tërësisë së ansamblit duke eliminuar pengesat fizike		x		x					
	VI.2 Përmirësimi, nëpërmjet interpretimit të përshatshëm, i informacionit të servirur rreth ansamblit			x	x					

IMPLEMENTIMI DHE MONITORIMI

10.1 DOKUMENTACIONI PËR IMPLEMENTIM DHE MONITORIM

MKRS duhet të jetë iniciator i dokumentacionit për implementim dhe monitorim, në përputhje të qëëlimeve të Planit të Menaxhimit. Hapë ë parë në kuadër të shumë paraparëve të planit të menaxhimit, duhet të jetë nënshkrimi i Memorandumit të Mirkuptimit (MiM). MiM nënshkruhet nga MKRS dhe Komuna e Prizrenit dhe përcakton përgjegjësitë dhe kohëzgjatjen të krijimit të Bordit Menaxhues, si dhe përcakton anëtarët specifik të propozuara.

MiM kryesishtë përcakton:

- Përgjegjësitë e Anëtarëve të Bordit Menaxhues
- Të drejtata e Anëtarëve të Bordit Menaxhues
- Afatin kohor të funksionalizimit të Bordit Menaxhues
- Mekanizmat e vendimmarrjes
- Përgjegjësitë financiare për funksionalizimin e Bordit Menaxhues dhe përcakton aktivitetet e lejuara në Hamam
- Fazat e implementimit të Planit të Menaxhimit në përputhje me këtë dokument.

Anëtarët e Bordit Menaxhues duhet të jenë përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për trashëgimi kulturore brenda përgjegjësive të përcaktuara nga kuadri ligjorë vendor. Për këtë arsye çdo anëtarë duhet të marrë në konsideratë kompetencat e institucionit që ata e përfaqësojnë.

Themelimi i Bordit Menaxhues duhet të jetë në përputhje të plotë me ligjet në fuqi,duke referuar në Ligjin për Trashëgimi Kulturore Nr.02/L-88;Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr.03/L-039 dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit nr. 04/L-06.

10.2 SISTEMI I APROVIMIT TË PLANEVE

Aprovimi dhe implementimi efikas i Panit do të kërkojnë plotësimin e hapave paraprake si në vijims:

- Sqarimi i pronësisë së lokalitetit, përdorimit dhe menaxhimit në saje të një marveshjeje të shkruar ndërmjet MKRS, Komuna e Prizrenit dhe Bashkësia Islame e Kosovës* dega në Prizren.
- MKRS, në kuadër të procesit të Ljubljanës II nevojitet të aprovojë Plnain e Menaxhimit për Hamamin e Gazi Mehmed Pashës, bazuar në Task Forcën për Kulturë dhe Shoqëri RCC (RCC TFCS).
- MKRS nevojitet të rregullojë statusin dhe implementimin të planeve menaxhuese, duke integruar në legjislacionin vendor. Rregullorja duhet të merret konkretishtë me hapat e parë që duhet ndërmarrë për funksionalizimin të strukturave të ngarkuara me

implementimin të planeve menaxhuese. Një shembull i mirë për t'u ndjekur do të ishte Rregullorja për Punën e Këshilloit të Librit, e cila përcakton veprimet ndërministrore në ndikim të shoqërisë civile.

Këto procese duhet të zhvillohen paralelishtë me procesin e funksionalizimit të Bordit Menaxhues.

10.3 MONITORIMI & RISHIKIMI

Ndryshimi i rrethanave mund të sjellë ndryshime në pikat kyçe të Planit. Gjithashtu, me daljen në dritë të informacioneve ose njohurive shtesë, kuptimi mbi rëndësinë e Lokacionit dhe pjesëve përbërëse të tij ndryshon. Të gjitha këto do të kenë efekt në menaxhimin afatgjatë të Lokacionit. Prandaj është e rëndësishme që Plani të monitorohet dhe rishikohet rregullisht.

Përgjegjësia për të organizuar dhe mundësuar monitorimin dhe rishikimet e Planit bie mbi Bordin Menaxhues. Pesha organizative për këtë detyrë mbi Komitetin do të reduktohet shumë nëse caktohet një nëpunës për Hamamin. Monitorimi dhe rishikimi do të jenë një pjesë e rëndësishme e punës së **Nëpunësit të Hamamit**.

Detyrat kryesore për monitorimin dhe rishikimin do të jenë:

- Rishikimi i punës të çdo viti siç është përcaktuar në planin e veprimit
- Raportimi i ecurisë dhe identifikimi i përparësive për vitin që pason.
- Vlerësimi i efektivitetit të veprimeve në arritjen e objektivave të Planit të Menaxhimit dhe rishikimi i drejtimit të përgjithshëm të Vizionit të tij në përgjigje të ndryshimit të përparësive dhe nevojave.
- Vlerësimi i progresit të Planit në lidhje me një seri treguesish.

Bordi Menaxhues vendos kriteret për raportimin periodik.

Një bazë e mirë për një monitorim efektiv të lokacionit ekziston tashmë përmes të dhënave dhe praktikave të përcaktuara të institucioneve dhe autoriteteve lokale të pranishme. Nëpunësi i propozuar për Hamamin mund të luajë një rol shtesë koordinues në mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve të nevojshme nga secila prej palëve kyçe të interesuara.

10.4 BURIMET

MKRS në cilësine iniciatorit të të procesit, mbulon shpenzimet të funksionalizimit të Bordit Menaxhues së paku një vit dhe detyrimishtë inkurajon aktivitetet që nxisin qëndrueshmëri ekonomike. Duke qenë një nga përfituesit drejtpërdrejtë nga aktivitetet në Hamam, Komuna e Prizrenit gjithashtu mundë të kontribojë në këtë buxhet.

PLANI I VEPRIMIT (PËRFSHIRË KOHËN, PRIORITETET, BURIMET DHE INDIKATORËT)

Objektivi kyç I **Të jep kontribut në zhvillimin lokal ekonomik dhe në mirëqenien e komunitetit (4.2.1)**						
Objektivi	**Aktiviteti**	**Personi/institucioni përgjegjës**	**Afati (1 deri në 5 vjet)**	**Kosto**[15]	**Burimi i financimit**[16]	**Treguesit**
I.1 **Ngritja e një sistemi hulumtimi për fonde dhe për aplikime me qëllim rritjen e fondeve në shërbim të Hamamit**	**I.1.1** **Sigurimi i fondeve për restaurim të plotë të Hamamit**	**Bordi Menaxhues, MKRS, Komuna**	**1**		**Prince Claus Foundation (CER program), MKRS, KK Prizren, WMF (World Monuments Fund)**	**Fondet e siguruar dhe zbatimi i fazës së dytë planit të restaurimit**
	I.2.1 **Përgatitja e strategjive vjetore për lobim/ngritje fondesh (aktivitet i përvitshëm)**	**Bordi Menaxhues, MKRS**	**1**		**MKRS; Fondi I Ambasadorëve**	**Fondet e mirëmbajtjes për dy vitet e para të siguruara**
I.2 **Rritja e aftësive koordinuese dhe mirëpritëse të aktiviteteve kulturorore në Hamam**	**I.2.1** **Përgatitja e një kalendari vjetor të aktiviteteve të organizuara në Hamam**	**Bordi menaxhues, QRTK Pz, Rrjeti i Organizatave lokale,**	**1**		**Në fillim KK Prizren, më pas me vetë financim**	**Kalendari vjetor me të gjitha të dhënat relevante lidhur me llojin, organizatorët, kohën dhe temat e aktiviteteve të hartuara**

[15]Nese dihet
[16]Nese dihet

	I.2.1 **Promovimi I kalendarit vjetor të aktiviteteve**	**Bordi menaxhues**	**1**		**Sponzorët vendor apo ndërkombëtar të biznesit**	**Përdorimi i kalendarit nga OJQ-të e ndryshme kulturore dhe turistike lokale; Rritja e numrit të vizitorëve të Hamamit.**
I.3 **Ofrimi i më shumë mundësive përjetimi nga komuniteti vendas dhe turistët**	**I.3.1** **Organizimi periodik në oborrin e Hamamit të nejave për komunitetit (brown-bag lunches, piknik etj).**	**Bordi Menaxhues, KK Pz-Drejtoria për Kulturë, QRTK Pz**	**1**		**Sponzorët lockal, Ambasadat**	**Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet e organizuara; Diversiteti i sektorëve pjesëmarrëse në aktivitetet.**
	I.3.2 **Përfshirja e Hamamit gjatë Dokufestit si lokacion për shfaqjen e dokumentareve.**	**Bordi menaxhues, Dokufest, QRTK Pz**	**1**		**Dokufesti**	**Kushtet logjistike për organizimin e aktiviteteve gjatë Dokufest siguruar; Numri i shfaqjes dhe punëtori të organizuara gjatë edicioneve vjetore DokuFestit.**
I.4 **Forcimi i kapaciteve vetë-financuese për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtejshëm**	**I.4.1** **Pajisja me një sistem biletash për vizitorët (projekt-pilot)**	**MTKRS, Bordi Menaxhues, QRTK Pz, BIK Pz**	**2**		**MKRS**	**Statistikat, monitorimi dhe vlerësimi i numrit të vizitorëve gjatë vitit**
	I.4.2 **Hartimi i një strategjie për çmimet e bilateve dhe shërbimeve tregtare të ofruara**	**MTKRS, Bordi Menaxhues, QRTK Pz, BIK Pz**	**3**		**MKRS**	**Qasje fleksibile për shërbimet e biletave, online ose versionin e shtypur**

Objektivi kyç II Të promovojë vlerat historike, artistike, shoqërore, shkencore dhe edukative dhe të ngrit vetëdijen e publikut rreth këtyre vlerave (4.2.2)						
Objektivi	**Aktiviteti**	**Personi/institucioni përgjegjës**	**Afati (1 deri në 5 vjet)**	**Kosto[17]**	**Burimi i financimit[18]**	**Treguesit**
II.1 Zhvillimi I infrastrukturës që do ti mundësojë vizitorëve një vizitë interesante dhe të sigurtë	**II.1.1 Restaurimi tërësor i Hamamit**	**QRTK Pz**	**2**	**400.000**	**MKRS, UNESCO, USAID, TIKA**	**Përmirësimi i gjendjes fizike të Hamamit; Ruajtja e vlerave të Hamamit; Kushtet për vendosjen e funksioneve të reja të ofruara.**
	II.1.2 Definimi i funksionimit Bzuar në projekt restaurimin (Ankes 2)	**Bordi Menaxhues, QRTK Pz,BIK**	**1**		**Vetëfinancim**	**Adaptimi dhe ri-destinimi i hapësirave të papërdorura**
	II.1.3 Kompletimi i planit përmasat e sigurisë për vizitorët (ndërlidhur me Planet e Menaxhimevedhetë mirëmbajtjes)	**BordiMenaxhues, QRTK Pz**	**2**		**KK Prizren**	**Sigurimi i ndërtesës nga rreziqet e mundshme: Naturore dhe njerëzore**
	II.1.4 Pajisja me dalje emergjence në rast zjarri a fatkeqësish natyrore	**BordiMenaxhues, QRTK Pz**	**2**			**Qasje të lehtë për daljet e emergjencës**
	II.1.5 Pajisja e ambjenteve me sinjalizues alarmi, kamera sigurie	**BordiMenaxhues, QRTK Pz,**	**2**			**Vëzhgimi online i ndërtesës në mënyrë konstante**
	II.1.6 Pajisja e objektit me ambjentet dhe kushte të mira sanitare	**Bordi menaxhues , QRTK-Pz**	**2**			**Funksionimi i sanitarisë dhe të dhomave utilitare**

[17]Nëse dihet
[18]Nëse dihet

	II.1.7 **Përgaditja e tabelave dhe shenjave informuese për Hamamin, brenda Prizrenit dhe në pikat kyçe.**	**MKRS, MTI, Komuna**	**2**		**MKRS, MTI, Komuna**	**Panelat të dizajnuara profesionalisht dhe të vendoszra në vendet kyqe**
	II.1.8 **Vendosja e një paneli informimi/interpretimi në hyrje të oborrit të Hamamit**	**QRTK-Pz, Komuna.**	**1**		**Komuna, MKRS**	**Vizitorët dhe kalimtarët të informuar në lidhje me aspektet kryesore të Hamamit**
II.2 **Rritja e qasmërishë dhe frekuentimit të nga të gjithë**	**II.2.1** **Përpilimi i planit të aksesit dhe qarkullimit të brendshëm për persona me aftësi të kufizuara**	**Bordi menaxhues , QRTK-Pz**	**5**		**Vetëfinancim**	**Numri i personave me nevoja të veçanta që vizitojnë / marrin pjesë në aktivitetet e Hamamit**
II.3 **Hapja ndaj publikut më të afërt**	**II.3.1** **Organizimi i vizitave tematike në Hamam me nxënës të shkollave fillore dhe të mesmë nga Komuna e Prizrenit**	**QRTK-Pz, Komuna**	**1**		**Ministria e Arsimit, KK Prizren Drejtoria per arsim**	**Numri i vizitave dhe nxënësit që marrin pjesë në aktivitetet.**
	II.3.2 **Krijimi i "Klubit të miqve të Hamamit" me nxënës të shkollave të mesme, për ndërgjegjësim**	**Bordi menaxhues , Komuna**	**1**		**Antarësim**	**Numri i takimeve dhe aktiviteteve të organizuara nga ky klub**
	II.3.3 **Përpilimi i një programi vjetor pastrimi të Hamamit nga fëmijë dhe prindër të Komunitetit**	**Bordi menaxhues , QRTK-Pz**	**1**		**Vetëfinancim**	**Niveli i pastërtisë në Hamam dhe përreth**
II.4 **Theksimi i vlerave edukative/shkencore të Hamamit**	**II.4.1** **Krijimi i një arkivi me burime të shkruara dhe fotodokumentacion rreth Hamamit të Prizrenit – Arkiv me dokumente të shtypura dhe në version elektronik.**	**QRTK-Pz, BIK-Pz**	**5**			**Themelimi injë databaze**

Objektivi kyç III **Të integrojë monumentin me vlerat dhe potencialin turistik dhe të përcaktojë mundësitë vlerave (4.2.3)**						
Objektivi	**Aktiviteti**	**Personi/institucioni përgjegjës**	**Afati (1 deri në 5 vjet)**	**Kosto[19]**	**Burimi i financimit[20]**	**Treguesit**
III.1 Përforcimi i kapaciteteve promovuese dhe të marketingut të Hamamit si një ikonë e rëndësishme kulturore	**III.1.1 Krijimi Brand-it të Hamamit (identiteti vizual, logo, strategjia e komunikimit)**	**Bordi menaxhues, MKRS**	**2**			**Përfitimet ekonomike nga ana e produkteve të brenduara**
	III.1.2 Aktivizimi i një webfaqeje specifike për Hamamin	**Bordi menaxhues, MKRS**	**2**			**Përdorimi i web faqes së internetit për organizimin e vizitave, aktivitetet dhe shitjet e biletave dhe rezervim**
	III.1.3 Aktivizimi në dhe përdorimi i rrjeteve e mediave shoqërore (për shëmbull hapja e një faqeje Facebook)	**Bordi menaxhues**	**1**			**Numri i pasuesve të informacionineve promovuar nga ky rrjet**
III.2 Rritja e pranisë së Hamamit në tregun e ofertave turistike	**III.2.1 Përfshirja e Hamamit në itineraret turistike për qytetin dhe rajonin Prizrenit (p.sh në kuadër të itenerarit të trashëgimis fetare në Pz).**	**Bordi menaxhues, Komuna Py-DZHET.dhe OJ-të (Kosovo* Guide)**	**1**			**Numri i ofertave turistike në nivel kombëtar dhe rajonal, ku Hamami është përfshirë si destinacion**

[19]Nëse dihet
[20]Nëse dihet

Objektivi kyç IV Të hartojë një plan veprimi, program i mirëmbajtjes dhe një rregullore të brendshme për mënyrën e shfrytëzimit të monumentit (4.2.4)						
Objektivi	**Aktiviteti**	**Personi/institucioni përgjegjës**	**Afati (1 deri në 5 vjet)**	**Kosto[21]**	**Burimi i financimit[22]**	**Treguesit**
IV.1 Krijimi i një rregulloreje bazuar në funksionimin e hamamit	**IV.1.1 Kompletimi i një rregulloreje të brendshëm, ecila do të përcaktjë aktivitetet të lejuara / të ndaluara në hamam**	**QRTK-Pz, Komuna.**	**1**			**Funksionimi dhe vendimmarrja në lidhje me funksionet e reja të Hamamit; Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Hamamit**
	IV.1.2 Draftimi i Planit vjetorë për mirëmbajtje të hamamit	**QRTK-Pz**	**1**			**Aktivitete të organizuara në përputhje me udhëzimet e deklaruar në rregulloren**
IV.2 Ngritja e kapaciteteve bazë të administrimit të vizitorëve	**IV.2.1 Ngritja e një sistemi të thjeshtë dhe funksional për numërimin e vizitorëve në Hamamin**	**Bordi menaxhues**	**1**			**Ruajtja e gjendjes fizike të Hamamit; Zvogëlimi i dëmeve**
IV.3 Ngritja një stafi të përgjegjshëm dhe efektiv	**IV.3.1 Vendosja e nje roje**	**Bordi menaxhues**	**1**			**Monitorimi dhe krahasimi i numrit të vizitorëve në periudha të ndryshme të vitit**
	IV.3.2 Vendosja e një zyrtari për Hamam	**Bordi menaxhues**	**1**			**Sigurimi i ndërtesës nga hajnat dhe veprimet vandale**

[21]Nëse dihet
[22]Nëse dihet

	IV.3.3 **Ngrtja e një sistemi për praktike të studentëve të Universitetit tëPrizrenit dega Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore dhe Turizm .**	**Bordi menaxhues**	**1**			**Koordinimi i aktiviteteve në mes të Bordit Drejtues dhe palëve të interesuara për përdorim të ndërtesës**

Objektivi kyç V Qartësimi i çështjeve pronësore-juridike të pronësisë dhe menaxhimit të Hamamit (4.2.5)						
Objektivi	**Aktiviteti**	**Personi/institucioni përgjegjës**	**Afati (1 deri në 5 vjet)**	**Kosto[23]**	**Burimi i financimit[24]**	**Treguesit**
V.1 Sqarimi i bazës rregullative mbi të cilin do të bazohet zbatimi i Olanit të menaxhimit	**V.1.1 Nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi për ndarjen e përgjegjësive dhe të drejtave respektive në kuadër të pronësisë dhe menaxhimit të Hamamit**	**MKRS, BIK-Pz**	**1**			**Zbatimi i përgjegjësive të përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit**
	V.1.2 Përcaktimi i kufijve mbrojtës të Hamamit	**QRTK-Pz , Komuna, KPTK**	**1**			**Aktivitetet e kufizuara të ndërtimit brenda zonës së mbrojtura të Hamamit**
V.2 Ngritja e një sistemi menaxhimit bazuar mbi frymën e bashkëpunimit mes palëve kyçe të interesit	**V.2.1 Themelimi i një bordi menaxhues për Hamamin**	**MKRS, BIK-Pz, Komuna.**	**1**			**Funksionimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional për arritjen e qëllimeve**

[23]Nëse dihet
[24]Nëse dihet

Objektivi kyç VI **Përfshirja e Hamamit si pjesë e një ansambli më të madh, dhe në përputhje me planet strategjike lokale , p.sh. Plani I Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit**						
Objektivi	**Aktiviteti**	**Personi/institucioni përgjegjës**	**Afati (1 deri në 5 vjet)**	**Kosto[25]**	**Burimi i financimit[26]**	**Treguesit**
VI.1 Përmirësimi i percpetimit publik lidhur lokalitetin duke larguar barierat fizike	**VI.1.1 Largimi i rrethojave metalike prej murit rrethues të oborrit të hamamit**	**Bordi Menaxhues, QRTK-Pz, Bik-Pz**	2			**Qasja e publikut në monument**
VI.2 Përmirësimi, në sajetë [nterpretimit tëpërshtatshëm të informacionit lidhur me ansamblin	**VI.2.1 Vendosja e një panoje që sqaron lidhjen në mes të hamamit dhe të ansamblit**	**Bordi Menaxhues, QRTK-Pz**	1			**Krijimi i kujtesës kolektive për një periudhë të kaluar në lidhje me këtë zonë: Rindërtimin virtual përmes modelimin 3d dhe imazhe të vjetra.**

[25]Nëse dihet
[26]Nëse dihet

Lista e akronimeve:

MKRS: Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
QRTK-P: Qendra Regjionale për Trashëgimi Kulturore – Prizren
Komuna: Komuna e Prizrenit
RRoK: Rrjeti i Organizatave Kulturore
CIC –P: Këshili i Bashkësisë Islame në Prizren
MI: Ministria e Insfrastrukturës
MTI: Ministria e Tregëtisë dhe Industris
KTK-Pz: Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Prizrenit

SHTOJCAT

Shtojca 1:
AKTIVITETET DHE VIZITAT NË KORNIZËN KOHORE GJATË 2012-2013

Viti 2012

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtatore	Tetor	Nendor	Dhjetor
Ekspozita artistike nga OJQ "ATTA"	Viztia edelegacionit të KFORit Gjerman	Ekspozita artistike nga OJQ "Sarski Behar"	Partia Politike Turke KDTP	Ekspozita artistike nga OJQ "EC MA Ndryshe"	Ekspozita artistike nga OJQ "Waking with Art'	Vizita e studentëve nga SHBA	Vizita e delegacionit nga Lindja e Mesme	Festivali ndërkombëtari i komedisë dhe karikaturës "Xhenet Comics"	Ekspozita artistike nga OJQ "FTDD"	Vizita e delegacionit pre Turqisë	Ekspozita artistike nga OSCE zyra Prizren
		Vizita e delegacionit prej Shqipërisë	Ekspozita artistike nga OJQ"Yunus Emre'"	Shënimi i ditës sërinjve të komunitetit turk	Ekspozita artistike nga OJQ "SOROS and ATTA"			Organizimi i festivalit Sculp edu OJQ "Leo's Art Organisation"	Organizimi i festivalit Sculp edu OJQ "Leo's Art Organisation"		Vizita e delegacionit pre Turqisë
			Reklamimi komercial nga "Frutex"	Vizita e delegacionit nga Japani	Organizimi i oncertitKlasik nga OJQ "Ngom"			Festimi i ditës së boshnjakëve mefilma emisione dhe ekspozitë artistike	Ekspozitë artistike nga Tirana "Vlora në shekullin e pavarësisë"		
				Vizita edelegacionit ngaPeja	Ekspozita artistike nga OJQ "Durmish Aslano"			Vizita e delegacionit nga Mbretëria e Bashkuar			
				Kuvendi Komunal Prizren	Ekspozita artistike nga OJQ"Akea"			Vizita edelegacionit të KFORit Gjerman			
					Vizita e studentëve nga Prishtina						

Viti 2013

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtatore	Tetor	Nendor	Dhjetor
Vizita e delegacionit të KFORit Francez	Vizita e delegacionit të KFORit Gjerman	Vizita e delegacionit të KFO Rit Gjerman	Ekspozitë personale artistike	Ekspozitë artistike për shënimin e Ditës së Evropës nga Komuna e Prizrenit	Ekspozita artistike nga OJQ "Waking with Art'	Ekspozita personale artistike të OJQ "Leo's Art Organisation"	Organizimi i ekspozitës "DokuPhoto" nga OJQ Dokufest	Organizimi i festivalit Sculp edu OJQ "Leo's Art Organisation"			
	Vizita e delegacionit të KFORit Gjerman	Vizita e OJQ " AWO "	OJQ "Innovation Lab Kosovo*"	Shënimi i ditës së rinjve të komunitetit turk	Organizimi i oncertit Klasik nga OJQ "Ngom"	OJQ "Akea" Organizon panair kulturor per nder të Ramazanit	OJQ "Akea" Organizon panair kulturor per nder të Ramazanit				
			Kuvendi Komunal i Prizrenit – Drejtoria për Kulturë Sport dhe Rini	OJQ turke organizon panir kulturor në oborr të hamamit	Vizita enxënësve të shkollave nga Prishtina						
			Partia Politike Turke KDTP	Vizita e studentëve	Vizita e delegacionit të KFORit Gjerman						
			Vizita e delegacionit të KFORit Zvicran		Vizita e studentëvenga SHBA						
			Vizita e delegacionit nga Shqipëria								

	Ekspozitat artistike
	Promovim të librave
	Panaire kulturore

	Koncertet
	Ligjeratat
	Vizitat – Delegacionet

Shtojca 2:

(Restaurimi GMP 4d Baza e përdhesës - Intervenimet; RestaurimiGMP 4f Baza e përdhesës – Destinimi, Restaurimi GMP 5d Tavani - Intervenimet)



RESTORATION / REHABILITATION OF:

GAZI MEHMED PASHA HAMAM - PRIZREN

Investor:

United Nations Educational,Scientific and Cultural Organization

Project Part :	Architectural
Phase :	Restoration
Survey :	Interventions
Description :	Ground floor
Scale :	1 : 50
Date :	.03. 2011
Nr. prot. :	02 / 2011

Project from:

Institute for the Protection of Monuments - Prizren

Page : 4/d

consultant : Prof.Dr. Zeynep AHUNBAY

project team : Jusuf XHIBO, Fikret TIKVES, Besart D. , Nehari T. , Kadër V.





RESTORATION / REHABILITATION OF:

GAZI MEHMED PASHA HAMAM - PRIZREN

Investor:

UNESCO
United Nations Educational,Scientific and Cultural Organization

Project Part :	Architectural
Phase :	Restoration
Survey :	Reuse-Destination
Description :	Ground floor
Scale :	1 : 50
Date :	.03. 2011
Nr. prot. :	02 / 2011

Project from:

INSTITUTI I MBROJTJES I MONUMENTEVE PRIZREN

Institute for the Protection of Monuments - Prizren

Page : 4/f

consultant: Prof.Dr. Zeynep AHUNBAY

project team: Jusuf XHIBO, Fikret TIKVES, Besart D. , Nehari T. , Kadër V.



remark:
In general interior must be cleaned,damges will be restored with lime mortar. Missed stones and bricks will be replaced. Cracks in the domes,vaults and arch will be injected (joined) with lime mortar (liquid) and special glue-epoxy. Surface of domes,vauts and archs where structure is good there must be joined with lime mortar,but where structure is bad then this surface will be rendered with khorosan mortar(~3cm). In female part of hammam except big dome (apodyterium) all domes,vaults and archs will be rendered with lime mortar - khorosan. Where the structure of the wall, the dome and pendentives is good, they will be left unplastered.

RESTORATION / REHABILITATION OF:

GAZI MEHMED PASHA HAMAM - PRIZREN

Investor: UNESCO United Nations Educational,Scientific and Cultural Organization

Project Part :	Architectural
Phase :	Restoration
Survey :	Interventions
Description :	Ceiling
Scale :	1 : 50
Date :	.03. 2011
Nr. prot. :	02 / 2011

Project from: Institute for the Protection of Monuments - Prizren

Page : 5/d

consultant : Prof.Dr. Zeynep AHUNBAY

project team : Jusuf XHIBO, Fikret TIKVES, Besart D. , Nehari T. , Kadër V.

Shtojca 3
Lista e Kontributit, Palët e Interesit

Emri/Mbiemri	Pozita	Profesioni	Organizata	Përgjegjësia	Kontributi
Jusuf Xhibo	Bahskëpuntor profesional	Arkitekt	Qendra regjionale për Trashëgimi Kulturore Prizren	Lider i Projektit	Draftimi i PIL, PTA dhe FS për hamam Drafton planin e restaurimit për hamam Mbikëqzr fazën e parë të restaurimit
Nora Arapi Krasniqi	Kordinatore për Qendrën Beledije	Aritekt, MrSc. Konzervimi i Monumenteve dhe lokaliteteve	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Grupi i ekspertëve lokal	Azhurimi i PIL-it ekzistues, PTA dhe FS më 2013 Draftimi dhe participimi në draftimin e planit të menaxhimit
Shpresa Osmanollaj	Arkitekt në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikim Hapësinor	Arkitekt	Kuvendi Komunal Prizren		Pjesmarrja aktiv në draftimin e plant të menaxhimit të hamamit
Vesel Hoxhaj	Anëtar i Këshillit	Historian, MA. Arkeologji	Këshilli i Prizrenit për Trashëgimi Kulturore		Pjesmarrja aktiv në draftimin e plant të menaxhimit të hamamit
Arbnor Morina	Anëtar i Këshillit	Skulptor	Këshilli i Prizrenit për Trashëgimi Kulturore		Pjesmarrja aktiv në draftimin e plant të menaxhimit të hamamit

Hajrullah Çeku	Udhëheqës i OJQ	Mrsc. Në Zhvillimin krahasues lokal	OJQ " EC MA Ndryshe"		Pjesmarrja aktiv në draftimin e plant të menaxhimit të hamamit
Artnet Haskuka	Bashkpuntor profesionist	Arkitekt Planer	UN Habitat		Pjesmarrja aktiv në draftimin e plant të menaxhimit të hamamit
Kujtesa Godeni	Arkitekt	Arkitekt	CHwB zyra në Kosovë*		Pjesmarrja aktiv në draftimin e plant të menaxhimit të hamamit
Orhan Bislimaj			Bashësia Islame e Prizrenit	Përfaqësues i pronarit juridik të ndërtesës	
Faik Bamja	Menaxher		Filigran		Pjesmarrja aktiv në draftimin e plant të menaxhimit të hamamit
Eroll Bilibani	Udhëheqës Ekzekutiv		Dokufest		Pjesmarrja aktiv në draftimin e plant të menaxhimit të hamamit

ZBATUAR NGA